

VENDIM
Nr.619, datë 8.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 23.6.2009 “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E BRENDSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.718, datë 23.6.2009, bëhen shtesat e ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit e personelit hetues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, për punonjësit civilë inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm”, e përmendur në pikën 6, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Paga e grupit (kolona 4) e lidhjes nr.2, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmësspecialist në provë në trupën operacionale	35 600	6 500
2	Agjent	Ndihmësspecialist në trupën operacionale	38 700	8 000
3	Agjent i I-rë	Drejtues grupi/ndihmësspecialist në trupën operacionale	43 700	8 000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor Specialist hetimi në nivel vendor në provë	53 100	8 000
5	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel vendor	66 200	8 000
	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel qendror Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	75 300	10 000
6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror	81 600	10 000

		Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror		
7	Drejtues i I-rë	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	91 600	10 000
8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të Hetimit)	96 400	15 000
9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	104 400	20 000

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES
DHE MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4	5	6	7
1	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	88 000	
2	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	71 000	
3	Punonjës të nivelit bazë drejtues	Shef sektori në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-a	1	2%	71 000	5000
4	Punonjës të nivelit bazë zbatues	Inspektor në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-b	1 ose 2	2%	54 000	5000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1 ose 2	2%	54 000	
		Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së	IV-a	1 ose 2	2%	43 000	5000
		Specialist në nivel qendror	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	43 000	
		Specialist në nivel qendror	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	33 000	

Lidhja nr.3

**VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT
UNIVERSITAR**

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
------------------	------------------	-------

1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë